



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Dëgjim publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024 – 2026 - Fshati Kërpimëh

Dëgjimi i parë publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024 – 2026, u mbajt në fshatin Kërpimëh, ku u diskutua për projektet të cilat kanë nevojë banorët e fshatit Kërpimëh dhe fshatrave përreth. Në këtë diskutim pjesëmarrës ishin Fatlum Osmani, Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Bahri Selimi, Drejtor i Shërbimeve Publike.

Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani e hapi këtë dëgjim publik, që u mbajt në fshatin Kërpimëh të Komunës së Podujevës. Osmani theksoi se ky dëgjim po mbahet për të diskutuar Kornizën Afatmesme Buxhetore të vitit 2024-2026. Në bazë të procedurave ligjore të ligjit për financa publike në bazë të qarkores buxhetore, organizon dëgjime publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore ku formon një kornizë e cila i paraprinë edhe hartimit të buxhetit për vitin pasardhës.

Osmani theksoi se në bazë të qarkores buxhetore të lëshuar nga Ministria e Financave, Komuna e Podujevës për vitin 2023 dhe për vitin në vijim 2024 dhe 2025, ka një rritje të vazhdueshme të buxhetit. Në vitin 2024 Komuna e Podujevës do të ketë një buxhet prej afër 31 milion që është buxheti më i madh në historinë e Komunës së Podujevës, dhe ka një dallim nëse e krahasojmë me vitin 2023 me rritje prej afër 4 milion euro nga 27 milion euro që ka qenë në këtë vit. Dhe nëse e krahasojmë edhe me vitin 2021 ku ka qenë 23 milion euro që i bie se kemi një rritje afër 8 milion euro, që është një rritje solide e buxhetit e cila na mundëson që të investojmë më shumë në çdo fushë të shoqërisë duke filluar nga arsimit, shëndetësia, infrastruktura, kultura e sporti dhe të gjitha veprimtaritë e tjera shoqërore.

Drejtori Osmani bashkë me drejtorin e Shërbimeve Publike, Bahri Selimi, theksuan që gjenden në këtë dëgjim në fshatin Kërpimëh në mënyrë që të marrin propozimet dhe sygjerimet e qytetarëve, që nevojat e tyre të inkorporohen në këtë dokument shumë të rëndësishëm ku prioritetizohen investimet dhe pastaj kthehen në ligj të buxhetit dhe realizohen ato.

Drejtori Osmani po ashtu e theksoi se si Komunë e Podujevës këto vite është bërë shumë përpjekje që t'i përgjigjen kërkesave dhe nevojave të qytetarëve. Me investime në arsim, shëndetësi, infrastrukturë dhe të gjitha nevojat të cilat i kanë qytetarët.

Drejtori Osmani tha se vlen të theksohet se në këto vite është prioritetizuar mjaft shumë arsimi, ku ka pasur një rritje të buxhetit në arsim, psh në kategorinë e investimeve kapitale deri në 16 herë, nga 100 mijë euro që kryesisht ka qenë buxhet në investimet kapitale në fushën e arsimit. Jemi në vitin 2023 me buxhet prej afër 1.6 milion euro, dhe kështu mendojmë që edhe në vitet e ardhshme në vitin 2024, 2025 dhe 2026 të kemi prioritet arsimin.

Pastaj edhe shëndetësinë ku kemi një rritje solide të buxhetit në të gjitha kategoritë solide të buxhetit duke filluar nga mallrat, subvencionet, investimet kapitale ku ka një përmirësim të dukshëm të shërbimeve shëndetësore ku njëherit është si rezultat i rritjes së buxhetit për fushën e shëndetësisë.

Gjithashtu kemi një rritje të buxhetit në kategorinë e subvencioneve, gjë që ka ndikuar që të kemi rritje të subvencioneve në fushën e bujqësisë ku në vitin 2023 kemi 700 mijë euro subvencione që pothuajse është dyfishim në rast se e krahasojmë me vitet paraprake. Dhe njëkohësisht me këtë ritëm planifikojmë që të vazhdojmë me subvencione në fushën e bujqësisë.

Gjithashtu kemi rritje të subvencioneve në fushën e kulturës dhe sportit, ku kemi afër pesëfishim të buxhetit në fushën e kulturës dhe sportit që padiskutim e kemi konsideru dhe e konsiderojmë si prioritet për zhvillimin shoqërorë dhe ekonomik të Komunës së Podujevës.

Me këtë rritje të buxhetit shtoi Drejtori Osmani me afër 4 milion euro në vitin 2024 që do të kemi në raport me vitin 2023, një pjesë e këtyre mjeteve do të shkoj në kategorinë e pagave pa dyshim për shkak të inkuadrimin të ligjit për paga që ka një ndikim tek shpenzimet në kategorinë e pagave. Mirëpo afër gjysma e tyre do të shkon afër dy milion euro edhe në kategoritë e tjera të mallrave, të investimeve kapitale, të subvencioneve etj.

Ne qoftëse e marrim buxhetin për investime kapitale në vitin 2023 është 9.2 milion euro dhe në vitin që po vjen do të shkojmë deri tek një buxhet afër rreth 10 milion e gjysmë euro. Varësisht nga planifikimi dhe nevojave të cilat do të paraqiten meqë jemi në fazën e hartimit të kësaj kornize buxhetore, dhe normalisht edhe nga kërkesat dhe nga prioritetet të cilat vinë nga qytetarët dhe grupet e tjera shoqërore të cilat kanë interes dhe normalisht me propozimet dhe sygjerimet e tyre na ndihmojnë që të kemi një buxhet i cili i përgjigjet më shumë nevojave të qytetarëve dhe zhvillimit shoqërorë dhe ekonomik të komunës sonë.

Edhe në fushën e infrastrukturës ka projekte goxha madhore të cilat janë duke u investuar sikur rrugët në qytet, projekte sikur që janë rruga “Skenderbeu”, rruga “Xhemajl Mustafa”, rruga të cilën e lidhë në brez të llapit me magjistrale, janë projekte madhore infrastrukturore. Mirëpo i është kushtuar rëndësi edhe projekteve të cilat janë në trajtimin e ujrave të zeza ku këtu është edhe drejtori i shërbimeve publike, ku është projekti madhor për ndërtimin e kolektorit i cili është projekt milionësh që normalisht do të prek çdo lokalitet që do të ndikoj në pastrimin e lumit llap, normalisht që pastaj do të ketë edhe ndikime të tjera pozitive kjo që është.

Gjithashtu ndërtimin e trotuareve, ndërtimin e ndriqimit, edhe në arsim ku kemi projekte edhe ndërtimin e shkollave dhe ndërtimin e qerdheve ku dihet që Komuna e Podujevës ka pasur vetëm një qerdhe dhe në këtë periudhë tri vjeçare meqë po flasim për kornizën buxhetore 2024, 2025, 2026, këtë periudhë do të kemi afër 14 qerdhe në Komunën e Podujevës.

Së bashku me një falenderim Drejtori Osmani ua kalon fjalën qytetarëve për të paraqitur kërkesat e tyre sygjerimet dhe propozimet e tyre për projektet prioritare dhe sektorë strategjik për të cilët ka nevojë të investohet në Komunën e Podujevës.

Bahri Kastrati, përfaqësues i lagjes Kastrati, në fshatin Pakashticë e Epërme – “ si fillim e shpreh pakënaqësinë për mungesën e një trotuari në rrugën “Çerqiz Topalli” që ka mbetë në gjysmë, dhe një në rrugën “Rushit Kastrati”. Një tjetër kërkesë e tij janë edhe shtrimi i disa rrugëve ku prej tyre më e rëndësishmja është një rrugë në të cilën gjinden tri familje me gjendje sociale, dhe një

e reshur e shiut po ua pamundëson qarkullimin, pjesa e pashtuar është 177 metra. Një kërkesë tjetër është edhe një rrugë 93 metra, ku kërkesën e thotë se e kanë bërë që 3 ose 4 vite dhe ajo rrugë tash është bërë 112 metra, dhe kërkesa ka hasur në vesh të shurdhur. Pastaj është edhe një rrugë tjetër që është shumë me rëndësi, është rruga që e lidh lagjen “Kastrati” me fshatin Pakashticë. Sepse në rast se bëhet ndonjë bllokim në rrugën “Çerçiz Topalli” ne po mbesim të bllokuar dhe nuk po mund të lëvizim poshtë sepse nuk kemi një rrugë alternative për me ardhë deri tek ambullanta për ndonjë shërbim mjekësor e hiq ma pak për në qytet. Ajo rrugë është dikun plus minus 800 metra, dhe nuk ka dalë askush nga komuna as me i shiku qëto kërkesa që i kemi ba na. Për trotuar na kanë lanë në gjysëm, kanë ardh deri te shpijat e Metehive dhe aty u mbet gjysëm. Tjetër është ndriqimi publik është ardhë vetëm deri në Kërpimeh. Dhe po ashtu shton se një kërkesë tjetër e ka që me iu jap më shumë subvencioneve banorëve të këtij fshati. Kto kërkesa shtoi ai i kam pas edhe në vitin e kaluar në 2022 edhe prap të njëjtat i kam me vete edhe këtë vit.”

Jusuf Gashi, përfaqësues i fshatit Dobërdol – “si kërkesë fillestare thotë se e ka zhvillimin ekonomik duke filluar nga bujqësia dhe lami të ndryshme si blegtori, bagëti e lami të tjera fitimprurëse. Ka shumë bujq në Dobërdol, njëri merret me misër edhe grurit e një tjetër me mjedrra, dredhza, specat dhe është një kërkesë për shtrimin e një rruge alternative që e lidh Metehi – Kërpimeh, dhe Kërpimeh – Dobërdol, dhe pjesa tjetër e lidh me Podujevën. Sepse kjo rrugë alternative e liron rrugën kryesore dhe i ndihmon këta që merren me bujqësi. Ndërsa një kërkesë tjetër është edhe shtrimi i një rruge me zallë për me iua lehtësu punën blegtorëve të këtij fshati. Për këtë kërkesë janë dy lagje ajo e “Kukufëve” dhe lagjia “Mërrniqve”. Një kërkesë tjetër është kanalizimi në lagjen “Celimajve”, i cili është mbyll për shkak të vërshimeve të lumit llap. Kërkesa tjera janë në aspektin e sportit për të ndihmuar klubin “Llapi” dhe në aspektin e shëndetësisë po ka probleme edhe për barna. Dhe si kërkesë të fundit ka pjesën e ndriqimit.”

Qefser Behrami, nga fshati Metehi njëkohësisht edhe drejtor i shkollës “Hamit Sejdiu” në Kërpimeh – “si kërkesë fillestare dhe më madhore thotë se e ka kërkesë ndërtimin e një qerdheje në Kërpimeh, po ashtu është edhe rregullimi i shkollës së vjetër të Kërpimehut të cilën e cilëson si shkollën e parë në Llap pas luftës. Kërkesë tjetër është ndërtimi i fushës sportive. Tjetër kërkesë është edhe rregullimi i 3 pendave të lumit Llap si shkak i të cilave reshjet e mëdha kanë ndikuar që banorët në Metehi të kenë vështirësi në kultivimin e tokave bujqësore. Pastaj është kërkesa për shtrimin e rrugës që lidhë fshatin Kërpimeh me fshatin Dobërdol.”

Bedri Kadriu, nga fshati Revuç – “kërkesat e tij i fillon me problemet në infrastrukturë ku thotë se ka shumë rrugë të pashtuara në fshatin Revuç, afërsisht 2 km e gjysmë që është një nga rrugët që ka nevojë më së shumti për asfaltim tek lagjia “Merovci”. Rrugë tjetër është ajo tek lagjia “Sinani” afër 200m në të cilën jetojnë afërsisht 10 shtëpi, rruga për tek Vrella një rrugë afër 3km që kërkesa është me shtriu vetëm me zallë. Kërkesë tjetër është edhe ndriqimi, që është ndërpre në mahallën e poshtme. Po ashtu kërkesë është edhe asfaltimi i rrugës që lidhë fshatin Revuç me fshatin Dobërdol dhe Lepaj me rreth 3km, që është një nga rrugët që mundëson lirin e rrugës për Kërpimeh.”

Bahri Kastrati, përfaqësues i lagjes Kastrati, në fshatin Pakashticë e Epërme – “ka edhe një kërkesë për rrugën që shkon për Kaçanoll, ku shembja e dheut e ka mbulu njërin shirit të rrugës komplet dhe e ka bërë të pakalueshme.”

Jusuf Gashi, përfaqësues i fshatit Dobërdol – “ po ashtu ka një kërkesë për një projekt që ka fillu por që nuk është realizuar, për instalimin e ujësjellësit për fshatin Revuç, që ka qenë me participim edhe nga banorët e këtyre fshatrave përreth.”

Bedri Kadriu, nga fshati Revuç – “ thotë se janë bërë analizat dhe hulumtimet dhe uji i vrellës është cilësuar si i pamjaftueshëm për të mbuluar të gjitha nevojat e banorëve që nuk kanë ujë të pijshëm.”

Jusuf Gashi, përfaqësues i fshatit Dobërdol – “ thotë se janë bërë shumë takime dhe konsultime, dhe ka pasur koordinim shumë të mirë për të shfrytëzuar ata ujë.”

Bahri Selimi, Drejtor i Shërbimeve Publike – “ fillon me përgjigjen ndaj kërkesave të banorëve, në kuadër të Shërbimeve Publike. Ai fillon me trotuaret në lagjen Kastrati ku thotë që është i informuar se ka qenë kërkesë edhe vitin e kaluar, dhe shton se prioritetet për ndërtimin e trotuareve janë vendet ku ka dendësi më të madhe të popullsisë dhe ku ka shkolla sepse frekuentimi i nxënësve është pak më i madh në mënyrë që të sigurohet një lëvizje më të lirë dhe më të sigurtë edhe nxënësve edhe qytetarëve. Ndërsa kërkesa për trotuare ka shumë. Ndërsa për asfaltimin e rrugëve siguron që do ti drejtoi tek drejtori i Urbanizmit të gjitha ato kërkesa. Sa i përket ndriqimit publik shpjegon ai se ka shumë kërkesa, sepse komuna e Podujevës ka shumë fshatra dhe po duhet të përfshihen të gjitha fshatrat me radhë, dhe varet edhe nga prioritetet. Ndërsa për rrugën kryesore që ka mbetur gjysmë tregon që ka hyrë në projekt për ndriqim dhe do të realizohet këtë vit. Ndërsa për rrugën në Kaçanoll nuk ka kompetenca Komuna, por që premtoi se do të bëhet një kërkesë në nivel qendror për këtë problem. Sa i përket subvencioneve në bujqësi thotë që i marrin të gjithë aplikuesit, që është një grand që vjen prej nivelit qendror, ndërsa grandet e vogla nga Komuna varen edhe nga nevojat e aplikuesëve dhe kriterëve që përcaktohen.”

Bahri Kastrati, përfaqësues i lagjes Kastrati, në fshatin Pakashticë e Epërme – “ shton se ka rreth 20 nxënës të cilët për të shkuar në shkollë kanë rreth 2km e gjysmë rrugë e që është e rrezikshme mungesa e trotuarit.”

Bahri Selimi, Drejtor i Shërbimeve Publike – “ shpjegon se këto projekte ndahen në bazë të prioritetëve dhe kriterëve që ka secila lagje dhe secila rend , dhe në secilin vend ku ka nevojë edhe ku kërkohet siguri më e madhe do të ketë trotuare. Dhe vazhdon për rrugët alternative dhe thotë se do ta adresoj tek Drejtoria e Urbanizmit. Ndërsa tek kanalizimet shpjegon se do të kryhet si kërkesë për shkak që kanë kontrata të vazhdueshme për mirëmbajtje dhe shumë shpejt do të bëhet deblokimi. Ndërsa tek ndriqimi në Dobërdol shpjegon se është prap e njëjta përgjigje se ka kërkesa të shumta dhe po mundohet me u ba njëfarë bilanci në ndriqim në të gjitha fshatrat. Ndërsa kolektori i ujërave të zeza në bashkëpunim me Austriakët është përfunduar faza e parë e ndërtimit të këtij kolektori deri në fshatin Llugë ka përfudnu pjesa e parë, ndërsa pjesa tjetër për arsye të kursimit të buxhetit ka me fillu me mjete të Komunës ku dikun rreth 2.7 milion euro do ti kushtojnë komunës rregullimi i pjesës së mbetur, gjithashtu projekti nuk ka ndryshu vetëm mjetet. Pjesa e ujësjellësit është një projekt që nuk e përballon Komuna, ndërsa projektet e tjera rrugët, qerdhja, renovimi i shkollës së vjetër, fusha sportive, rrethojat të cilat janë të gjitha të nevojshme do të adresohen në drejtoritë përkatëse. Ndërsa pendat e bllokuara po shihet që ka probleme por që Komuna nuk po mundet me ba zgjedhje përveç që kur po ka vërshime me ba deblokime të shpejta, ndërsa në vazhdim do të mendojmë për një zgjedhje afatgjate, më lehtë të

mirmbajtshme. Ndërsa ka treguar se do të merren seriozisht me qështjen e ndriqimit të shpata për të mundësuar kyqjen në energji elektrike në mënyrë që ndriqimi të funksionoj.”

Fatlum Osmani, Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – “ shpjegon se prej kërkesave të shumta në shumë sfera Komuna e Podujevës shëndetësinë e ka primare në furnizim me barna dhe furnizime të tjera në masë të mjaftueshme të shëndetësisë primare. Ndërsa ka hapësirë për përmirësime në të gjitha sferat në aspektin e shëndetësisë. Në aspektin e bujqësisë Komuna ka një projekt diku 400 mijë euro subvencione në fushën e bujqësisë, përafërsisht një dyfishim i subvencioneve të bujqësisë. Ndërsa edhe në kulturë edhe në sport ka një subvencion prej afërsisht 250 mijë euro, por që nuk janë të mjaftueshme që të ndihmohen të gjitha klubet në Komunën e Podujevës. Ndërsa në kulturë i është kushtuar shumë vëmendje ngritjes së infrastrukturës kulturore, ku është funksionalizu biblioteka e qytetit, galeria e qytetit në të cilën janë mbajtur shumë aktivitete këtë vit. Ndërsa në procedura të prokurimit gjendet projekti i ndërtimit të qendres multifunkionale ku do të përmbajë të gjitha veprimtaritë kulturore. Ndërsa në aspektin e funksionalizimit të qerdhes në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit mendohet që në shkollën e vjetër të fshatit Kërpimëh të funksionalizohet qerdhja në vitin 2023, po ashtu janë bërë bisedime edhe për ndërtimin e sallës së edukatës fizike për shkollën e Kërpimëhut. Ndërsa aspekti i qerdheve dhe arsimit është prioritet i Komunës sepse konsiderohet si proces i rëndësishëm për zhvillimin e aspektit shoqëror dhe ekonomik në Komunën e Podujevës, në mënyrë që gratë e Podujevës të inkuadrohen në tregun e punës.

Bahri Kastrati, përfaqësues i lagjes Kastrati, në fshatin Pakashticë e Epërme – “ prap kërkon nga komuna që të prioritetizohet asfaltimi i rrugës së 3 shtëpive që janë rastë sociale në Pakashticë të Epërme.”

Bahri Selimi, Drejtor i Shërbimeve Publike – “ Komuna e Podujevës ka shumë kërkesa për shtrimin e rrugëve, por selektimi i tyre do të bëhet sipas prioriteteve. Zyrtarët do të inspektojnë në vendin e ngjarjes dhe do të vlerëohet nëse i mbushin kriteret për asfaltim, dhe nëse ka mundësi do të inkuadrohet në buxhet. Nuk aka kërkesë që nuk shqyrtohet nga drejtoria qoftë nga zyrtarët, drejtori apo edhe Kryetari.

Fatlum Osmani, Drejtor i Financave i falënderon shumë pjesmarrësit në dëgjim publik dhe e përmbyll diskutimin.

29 maj/ Fshati Kërpimëh



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Debat Publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026 (KAB), banorët e fshatit Kërpimëh dhe fshatrave përreth.

Lista e nënshkrimeve të pjesëmarrëseve:

	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nënshkrimi
1	Nexhat Kastrati	Pakoshticë e Poshtme	
2	Lotiçe Tushaj	Revuge	
3	Jusuf Gashi	Dobëdoj	
4	Behar Adem	Motin	
5	Olges Ademi		
6	Perdorim Kodru	Revug	
7	Redi Kodri	Revugë	
8	BAHRI KASTRATI	PAKOSHTICË E EPËRME	
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			

22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			

Vërejtje: Nënshkruhen të gjithë ata persona të cilët pajtohen që të dhënat e tyre dhe fotot mund të përdoren për publikim e procesit të konsultimeve në ueb faqen zyrtare të Komunës së Podujevës.

Podujevë

29.05.2023



Debat publik për Kornizën Afatmesme Buxhetor

